



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.54/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.54/2025 e datës 17.01.2025.
- II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 8,000.00 (tetëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 17.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se Armend Ahmeti, punonjës në Komunën e Skenderajt dhe aktivist i Subjektit Politik PDK, në profilin e tij facebook story ka postuar një video në të cilën nënkryetari i PDK-së, Sami Lushtaku, i ka quajtur aktivistet e Lëvizjes Vetëvendosje "zagar".

Sipas parashtruesit të ankesës në videon e publikuar në profilin e Armend Ahmeti, mes tjerash thuhet "T'i çojna mesazh Albin Kurtit dhe zagarve të tij..." duke shkelur dispozitat e nenit 34, pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur një CD, në ankesën e tij.

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 18.01.2025, Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se përmes rrjetit social facebook iu është adresuar të gjithë anëtarëve aktivistëve dhe përkrahësve të Subjektit politik PDK, duke ju bere thirrje që të njëjtit gjatë kësaj periudhe kohore të fushatës zgjedhore të përdorin gjuhë të respektueshme të shmangin



gjuhen nxitëse, fyese ose urrejtjeje si dhe të respektojnë ligjet dhe rregullat zgjedhore të cilat përveç se përbejnë detyrim ligjor është edhe me përgjegjësi morale që forcon demokracinë dhe ndërton themelet për suksesin e përbashkët.

Tutje në përgjigje PDK, sqaron se nuk përjashton mundësin që edhe ditëve në vijim të ketë veprime të tilla të përkrahësve votuesve dhe simpatizantëve të PDK-së, e të cilat mund të jetë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara, si me rregullën zgjedhor e Nr.07/2024. Duke pasur parasysh faktin se është e pamundur që të mbahen nën kontroll veprimet e të gjithë simpatizantëve përkrahësve dhe votuesve të PDK-se. Mirëpo PDK, garanton se çdo herë dhe çdo rast pas marrjes se informatave për shkelje të tilla do të ndërmarr masa përmirësuese për evitimin e këtyre shkeljeve.

Po ashtu në rrethanat e rastit konkret si në ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit PDK, ka ndërmarr të gjitha masat paraprake për evitimin e këtyre shkeljeve, duke bërë thirrje publike që të gjithë simpatizantët votuesit e PDK, të përmbahet nga shkeljet e Rregullave Zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të bërë artikullit të ofruar si provë materiale CD e cila është publikuar në rrjetin social Facebook, prej nga shihet se Armend Ahmeti, punonjës në Komunën e Skenderajt dhe aktivist i Subjektit Politik PDK, në profilin e tij facebook ka postuar një video në të cilën kryetari i degës së PDK-së, në Skenderaj, Sami Lushtaku, i quan aktivistet e Lëvizjes Vetëvendosje "zagar", me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe promovimit të Subjektit Politik PDK, ka nxitur urrejtjen ndaj aktivisteve të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në atë mënyrë që përmes përdorimit të gjuhës denigruese dhe urrejtëse ka bërë etiketim ndaj Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe atë duke i përdorur fjalën "T'i çojna mesazh Albin Kurtit dhe zagatve të tij..."

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.", ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e bazuar.

Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për



*financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetë mijë (50,000.00) euro”.*

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj aktivisteve të Subjektit Politik LVV, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit mund të rrisë tensione mes subjekteve politike. Vlerësohet se përdorimi i kësaj gjuhe minon frymën e konkurrencës së drejtë dhe respektit reciprok mes subjekteve politike.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Subjekti politik PDK në përgjigje në ankesë ka theksuar se përmes rrjetit social facebook, iu është adresuar të gjithë anëtarëve aktivistëve dhe përkrahësve të Subjektit politik PDK, duke ju bere thirrje që gjatë kësaj periudhe kohore të fushatës zgjedhore të përdorin gjuhë të respektueshme, të shmangin gjuhen nxitëse, fyese ose urrejtjeje si dhe të respektojnë ligjet dhe rregullat zgjedhore, mirëpo siç rezulton nga provat e bashkangjitur thirrja nga subjekti politik është bërë pasi që ka ndodhë shkelja, andaj Paneli nuk ka mundur që në këtë rast thirrjen e subjektit politikë në fjalë ta marrë si rrethanë ndikuese në vendimmarrje.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.54/2025 më datë 19.01.2025

Kryesues i Panelit  
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.